



PUNËSIMI I SUBVENCIONUAR

Analiza e kostove dhe përfitimeve:

Punësimi i subvencionuar i të rinjve të papunë deri në moshën 29 vjet nëpërmjet lirimit nga kontributet



Stërvitje:

Autorë

Kristijan Panev - Fondacioni për zhvillim të bashkësive lokale - Shtip
Aleksandar Xhagaduroski - Qendra për strategji dhe zhvillim Paktis - Prilep

Mentorë

Pavle Gacov - Pro Agens

Përktheu

Nevrije Shabani

HYRJE

Pavarësisht nga tendencat pozitive të arritura në vitet e fundit, papunësia e lartë mbetet një nga indikatorët më të këqij të suksesit të politikës së aplikuar makroekonomike dhe sociale të vendit që nga pavarësia e saj. Veçanërisht të pavolitshëm janë treguesit për nivelin e papunësisë në mesin e të rinjve nën 29 vjeç (mosha menjëherë pas formimit të edukimit formal). Papunësia në këto vite është një nga arsyet kryesore për largimin e të rinjve jashtë vendit. Motivi është i qartë - për të kërkuar punë. Punësimi i të rinjve në vend do të zvogëlojë trendin e emigracionit, por edhe do të ndikojë pozitivisht edhe në shumë segmente të jetës social-ekonomike të vendit.

Për të nxitur punësimin e të rinjve nga 15 deri 29 vjet, shteti zbaton masa dhe politika të shumta, e një prej tyre është subvencionimi i punësimit për të papunët e rinj deri në 29 vjet nëpërmjet regjimit të lirit nga kontributet sociale.

Të inkurajuar nga rezultatet e para të kësaj mase, në Planin e ri të veprimit për punësimin e të rinjve për periudhën 2016-2020 është paraparë vazhdimi i tij. Tani për tani, kjo nuk është shndërruar në kuadër konkret ligjor. Plani i ri i veprimit për punësimin e të rinjve për periudhën e viteve 2016-2020 (faqe 26 dhe 33) siguron një zgjatje të masës dhe në 2016 me parametrat e mëposhtëm: punësim të planifikuar të 3,000 njerëzve prej 15 deri 29 vjet dhe një buxhet në vlerë 2.040 .000 euro. Efektet e masave dhe politikave të planifikuara për punësimin e të rinjve nën 29 vjet do të varem nga zbatimi i suksesshëm i masave të planifikuara për zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Objekti i interesit tonë është masa e punësimit të subvencionuar për të rinjtë e papunë deri në 29 vjet nëpërmjet formës duke i liruar nga pagesa e kontributeve në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara.

Analiza e lëndës së objekt rreth shpenzimeve dhe përfitimeve ka për qëllim për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e masës, Punësimi i subvencionuar për rinjve të papunë deri në 29 vjet nëpërmjet lirit nga kontributet. Masa është pjesë e politikës shtetërore për zvogëlimin e papunësisë dhe është rregulluar nga dispozitat e Ligjit për punësim dhe sigurinë në rast papunësie (neni 98-b dhe 98-c), të cilat kanë aplikim të kufizuar nga marsi i vitit 2014 deri në mars të vitit 2016.

Analiza është strukturuar në hyrje dhe në tetë pjesë kryesore:

1. Trendët
2. Korniza ligjore
3. Kushtet dhe rregullat për përdorimin e masës
4. Fakte për masën
5. Analiza e kostove dhe përfitimeve
6. Analiza cilësore
7. Përfundimi
8. Rekomandime

TRENDET

Sipas Strategjisë Kombëtare të Punësimit (Министерство за труд и социјална политика, 2011), viteve të fundit është arritur një përmirësim në situatën në tregun e punës. Shkalla e punësimit është rritur, duke përfshirë punësimin e grave dhe të mos-huarve. Punësimi në të kaluarën u rrit në mënyrë të vazhdueshme midis viteve 2009 dhe 2014 me ç'rast numri i të punësuarve u rrit me 62.3 mijë që është 10 për qind e punësimit të tanishëm. Logjikisht sipas kësaj, pra rritjes së punësimit, është ulur shkalla e papunësisë.

Edhe pse përdorin metodologji të ndryshme dhe për këtë prezantojnë tregues të ndryshëm absolut, të dhënat e fundit të Entit Shtetëror të Statistikës dhe Agjencisë për punësim të RM tregojnë të njëjtat trendë në këtë fushë.


Sipas Entit shtetëror për statistikë, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2015 shkalla e përgjithshme e papunësisë vazhdon prirjen rënëse, duke arritur në 25.5 për qind. Për fat të keq, mbetet ende më e madhe papunësia ndërmjet të rinjve prej 15 deri 24 vjet, e cila është tepër e lartë dhe përfshin 48.2 për qind.

Од друга страна, според податоците на Агенцијата за вработување на РМ, на Sipas Entit shtetëror për statistikë, numri i përgjithshëm i të papunëve në Maqedoni arriti në 243,230 persona

Në anën tjetër, sipas Agjencisë për Punësim të RM, në 11.30.2015, numri i përgjithshëm i personave të papunësuar (personat të cilët në mënyrë aktive kërkojnë punë) ishte 115,784 persona¹, prej të cilëve 28 589 persona janë të moshës 29 vjet (rreth 1/4 e totalit të numrit të personave të papunë).

Grafiku 1.

Struktura e papunësisë sipas moshës në fund të tremujorit të tretë të vitit 2015



Adaptuar sipas : Anketat e Forcave të Punës, ESHS

¹ Së bashku me persona të tjerë që kërkojnë punë (95,510) në fund të nëntorit 2015 në EPRM janë evidentuar gjithsej 211.294 të papunë. Për krahasim, sipas APRM, numri i të papunëve në 31.12.2006 ishte 266 551

Për të shqyrtuar tendencat e lëvizjes të shkallës së papunësisë Republikën e Maqedonisë në vazhdim prezantojmë pasqyrën e të dhënave mbi shkallën e papunësisë sipas grupmoshës për periudhën nga viti 2009 e këndej. Të dhënat janë marrë nga raportet e ESHS dhe nga analizat e BPRM.


Tabela 1. Shkalla e papunësisë për periudhën 2009 - III / 2015

Nr.rnd	Moshë	Viti (Papunësia në %)						
		2009	2010	2011	2012	2013	2014	III 2015
0	Total	32,4	30,9	31,8	30,6	28,6	27,6	25,5
1	15-24	56,6	50,5	59,4	53,0	50,3	50,4	48,2
2	25-49	30,8	30,3	29,5	29,9	27,4	25,7	23,8
3	50-64	25,4	24,7	25,2	23,2	22,7	24,7	22,1

Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, ESHS dhe raportet BPRM

Grafiku 2.

Trendi i lëvizjes së papunësisë te të rinjtë prej 15 deri në 24 vjet



Adaptuar sipas: Entit shtetëror të statistikave, Banka popullore e RM

Pandan tendencave të mëparshme, edhe Plani i veprimit për punësimin e të rinjve për periudhën 2016-2020, tregon një drejtim të qartë për uljen e papunësisë tek të rinjtë prej 15 deri 29 vjet. Megjithatë, është interesante për të krahasuar raportet e ndryshme të brendshme në mes të tre grup moshave të papunëve.

Tabela 2. Papunësia sipas strukturës së moshës për periudhën e viteve 2011 – 2014

Moshë e grupit	Viti (papunësia në %)			
	2011	2012	2013	2014
Niveli i papunësisë i personave të moshës 15 - 24	55,3%	53,9%	51,9%	53,1%
Niveli i papunësisë i personave të moshës 25 - 29	47,0%	47,0%	45,5%	45,1%
Niveli i papunësisë i personave të moshës 30 - 64	28,7%	26,0%	24,0%	22,9%

Burimi: Plani i Veprimit për punësimin e të rinjve për periudhën 2016-2020 vit

Nga tabela 2 dalin disa përfundime të rëndësishme:

- Papunësi më të lartë ka në mesin e të rinjve të moshës 15 deri 24 vjeç. Në periudhën e analizuar prej katër vitesh, tendenca në rënie e papunësisë në mesin e këtij grupi nuk është konsistente, pra pas një rënie dy-vjeçare në vitin 2014 papunësia në mesin e kësaj popullate është në rritje.
- Më mirë është situata me papunësinë mes të rinjve të moshës 25 deri në 29 vjet. Në këtë grup, pas stagnimit në vitin 2012, është realizuar një tendencë në rënie e papunësisë. Nëse krahasohen këto dy grupe (24 deri 29 vjet) mund të konstatojmë se në pozitë më të mirë janë të rinjtë e moshës 25 deri në 29 vjet. Kemi të bëjmë me një përfundim logjik, se kjo grup moshë, si rregull, ajo ka përfunduar arsimimin formal dhe disponon aftësi të fituara përmes formave të ndryshme të trajnimit.
- Shkalla e papunësisë në mesin e personave të moshës 30 deri 64 vjet është pothuajse më pak se gjysma e shkallës së papunësisë në mesin e të rinjve deri në 24 vjet, përkatësisht papunësia mes të rinjve deri në 24 vjeç është dy herë më e madhe se shkalla e papunësisë për njerëzit e moshës 30 deri në 64 vjet. Ky krahasim është pak më i mirë kur është fjala për raportet: papunësia e të rinjve të moshës 25 deri në 29 vjet në krahasim me ata të moshës 30 deri në 64 në favor të të rinjve të moshës 25 deri në 29 vjet. Tendanca në rënie të papunësisë në grup moshat më të vjetra është më e evidente.

Për të zgjidhur problemin e papunësisë së lartë në mesin e të rinjve deri 29 vjeç kërkohen masa sistematike për të stimuluar punësimin e tyre. Vazhdimi i status quo-së për këtë kategori të të rinjve nuk paraqet një opsion të përshtatshëm për ata që bëjnë politikën dhe masat për punësim. Në fakt, tregu i punës nuk e njeh aq mirë përparësinë e të rinjve, energjinë e tyre, aftësinë e njohurive të gjuhëve të huaja dhe aftësive të tjera të të rinjve. Dispozitat ligjore (nevoja për „diskriminim” të vazhdueshëm pozitiv), vlerat tradicionale shoqërore, valët sindikale, politika e punësimit dhe politikat e arsimit, mungesa e praktikës së detyrueshme dhe mbi të gjitha, praktika cilësore nxënësve dhe e studentëve etj. paraqesin pengesat sistematike për punësim më të madh të të rinjtë.

Për shkak të mungesës së mekanizmave të qenësishëm për të favorizuar sistemin e punësimit të të rinjve ishte e nevojshme për të marr veprim shoqëror , duke kriju-

ar legjislaconin juridik dhe të miratohen masa dhe politikat aktive dhe planin i duhur operativ nga organet kompetente kombëtare për të mbështetur (subvencionuar) punësimin e të rinjve deri në 29 vjet.

Natyrisht, diskriminimi pozitiv i punësimit të të rinjve mund të ketë një ndikim në ngushtimin e tregut të punës për kategoritë e moshave e tjera. Kjo mundësi reale është relativizuar me një varg masash ligjore për punësim të subvencionuar të personave deri moshën 35 përkatësisht 50 dhe 58 vjet. Nuk mund të shmanget as fakti se disa punësime të reja formale, në fakt do të jetë një zyrtarizim i papunësisë së përhershme jo-formale.

KUADRI LIGJORE

Kuadri ligjor për zbatimin e masës së Punësimit të subvencionuar të të rinjve të papunë deri në 29 vjet nga lirimi i kontributeve² është përfshirë në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë - LPSRP (ndryshim dhe plotësim konkret të Ligjit, publikuar në „Gazetën Zyrtare” Nr. 44/2014 hyrë në fuqi më 13 mars 2014 dhe aplikohet për një periudhë prej dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi, pra deri më 13 mars 2016)³.

Subvencionimi i kontributeve sociale, përveç pagesës së të rinjve të sapo punësuar, vlen edhe për personat e vetëpunësuar deri në 29 vjet.

Përfitimet për punëdhënësit

Sipas Nenit të ri 98-b të ZVOSN punëdhënësit e sektorit privat, i cili pas kërkesës të bërë në Agjencinë për Punësim (APRM) do të punësojë një person të papunë nën 29 vjeç me kohë të plotë, në të cilin nuk ka ulje të numrit të punonjësve ke kohë të pacaktuar nga 31 dhjetori i vitit 2013 deri në datën e punësimit të punëtorëve të rinj, përveç në rastet e vdekjes ose të daljes në pension, ai do të lirohet nga pagesa e kontributeve për sigurimin e detyrueshëm shoqëror.

Lirimi ka të bëjë për kontributet e mëposhtme të sigurimit të detyrueshëm social:

- | | |
|---|--------------------|
| • Kontributi për sigurim pensioni i dhe invaliditeti, | shkalla prej 18% |
| • Kontributi për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, | shkalla prej 7.3% |
| • Kontributi për sigurim shëndetësor të detyrueshëm në rast të e lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale, | shkalla prej 0.5% |
| • Kontributi i për sigurimin të detyrueshëm në rast të papunësisë, | shkalla prej 1.2%. |

² Evidenca e punëdhënësve nga sektori privat dhe të papunëve deri në 29 vjeç, me orar të plotë dhe të personave të vetëpunësuar deri në 29 vjet është mbajtur nga Agjencia për punësim e RM.

³ Gjatë miratimit të masës për punësim të subvencionuar të të rinjve deri në 29 vjet, duke u liruuar nga pagesa e kontributeve shoqërore, në fund të tremujorit të parë të vitit 2014, sipas Entit Shtetëror të Statistikës nr. 2.1.1.17 datë 06.12.2014, shkalla e papunësisë ishte 28.4 për qind dhe papunësia e të rinjve 15 deri 24 vjet është 54.6 për qind. Në periudhën e analizuar III / 2015: I / 2014 papunësia totale është ulur me 10.2 për qind, dhe papunësia e të rinjve në 15 deri në 24 vjet për 11.7 për qind.

Shkalla e përgjithshme e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore llogaritet dhe mbahet nga paga bruto si bazë është 27%.

Shuma e llogaritur e kontributeve të pagave të cilën punëdhënësit nuk do ta paguajnë për të mirën e fondeve sociale do të jetë kursimi i tyre.

Për shkak të ruajtjes së konceptit të financimit të fondeve, kontributet e papaguara të rrogës nga ana e punëdhënësit do të mbulohen nga mjetet buxhetore, përkatësisht nga programi i veçantë i APRM.

Përveç kontributeve, punëdhënësi që do të punësojë punëtorë në kohë të pacaktuar mbi numrin e të punësuarve me kohë të pacaktuar në ditën e punësimit të punëtorëve të rinj, lirohen nga tatimi mbi të ardhurat personale për punëtorët e sapo punësuar për një periudhë prej tre vjetësh. Për të ushtruar këtë të drejtë, ky punonjës i ri duhet të jenë i regjistruar si i papunë në Agjenci të paktën një vit.

Nëse punëdhënësi e redukton numrin e të punëtorëve të punësuar për një periudhë të pacaktuar në ditën e punësimit të punëtorëve të rinj, ai e humbet të drejtën e lirit dhe është i detyruar të paguaj tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën për të cilën ai kishte të drejtë të lirit nga tatimi

Punëdhënësi që fillon kryerjen e veprimtarisë si një punëtor individual tregtar ose themelon kompani tregtare, si dhe personi fizik i cili punon në përputhje me ligjin, ka të drejtë për këtë lirim, nëse paraqesë prova nga organi kompetent i regjistrimit se para fillimit të aktivitetit nuk ka qenë e regjistruar për të ushtruar këtë veprimtari.

KUSHTET DHE TË DREJTAT PËR TË SHFRYTËZUAR KËTË MASË

Lirimi nga pagesa e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore ka të bëjë për një periudhë prej 12 muajsh nga data e punësimit të personit.

Lirimi nga pagesa e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore në baza mujore i referohet pagës mesatare bruto për vitin paraprak të publikuar nga Instituti Shtetëror i Statistikave, ndërsa dallimi mbi pagën mesatare bruto llogariten edhe paguhen kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror.

Paga bruto për vitin 2014 publikuar nga ESHS është 31 325 denarë ndërsa e dhëna mbi pagën bruto për vitin 2015 do të jepet më 25 shkurt 2016. Sipas këtyre të dhënave, kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore përfshin:

PUNËSIMI I SUBVENCIONUAR

Paga bruto	Kontribute (në denar)				Kontribute totale (në denar)	Tatimi personal (10%)	Paga neto
	SPI (18%)	Shëndetësi (7,3%)	Papunësia (1,2%)	Shëndetësi prof. (0,5%)			
31.325	5.639	2.287	376	157	8.458	1.555	21.312

Vërejtje: Në bazë të nenit 15, paragrafit 1 të Ligjit të kontributeve, baza për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve nuk mund të jetë më e ulët se 50 për qind e pagës mesatare për punëtor në Republikën e Maqedonisë, të publikuar në janar në vitin aktual, sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë .

Baza më e ulët për llogaritjen e kontributeve të pagës për vitin 2015 ishte 15 822 denarë. Sipas kësaj baze më të ulët, kontributet e pagave për vitin 2015 nuk mund të jenë më pak se 4272 denarë.

Sipas Ligjit të pagës minimale në Maqedoni paga minimale neto për vitin 2015 dhe 2016 është si vijon:

Viti	Paga minimale (në denarë)	
	Për të gjithë subjektet	Për sektorët e caktuar të tekstit, veshjes dhe lëkurës dhe prodhimeve të ngjashme të lëkurës
2015	9.590	8.050
2016	10.080	9.000

Paga minimale është shuma më e ulët mujore e pagës bazë, të cilën punëdhënësi është i detyruar t'ia paguajë të punësuarit për punën e kryer për kohë të plotë dhe kontributin e kryer të normës. . Regjimi i pagës minimale nuk ka të bëjë me personat e vetëpunësuar.

Po përmendi, se në kushte të pagesës së pagës minimale, kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror (kujtojmë se në vitin 2015 shuma minimale mujore e kontributeve për punonjës është 4272 denarë) paguhen në bazë të përcaktimit ligjor më të ulët për llogaritjen e kontributeve (15,822).

Sipas detyrimeve të mëparshme ligjore dalin këta limite të detyrueshme:

- paga neto minimale për vitin 2015 nuk mund të paguhet në një shumë më të ulët se 9.590 denarë (dmth 8.050 denarë)
- kontributet e llogaritura dhe të paguara nga rroga që bien në buxhetin e RM nuk mund të jenë më e ulëta se 4272 denarë, por nuk mund të jenë më të larta se 8458 denarë (llogaritur nga 31 325 denarë që është kufiri ligjor)
- tatimi i llogaritur personal i paguara nga paga minimale neto është 252 dinarë (për pagë minimale prej 9.590 denarë), ose 81 denar (për pagë minimale prej 8,050 denarë)
- për pagë neto më të lartë se 21,312 dinarë (korrespondon me pagesën-bruto: 31 325 denarë) kontributet e pagave do të përballohen nga punëdhënësi.

Punëdhënësi është i detyruar të mbajë të punësuarin nën moshën 29 vjet edhe 12 muaj pas periudhës në të cilën është i liru nga pagesa e kontributeve për sigurim të

detyrueshëm shoqëror. Kjo do të thotë se punësimi i këtyre personave do të zgjasë të paktën 24 muaj. Për të ashtuquajturën „punësimi mbajtur“ për periudhën e 12 mujorit të e dytë, shpenzimet e kontributeve shoqërore nuk subvencionohen nga shteti dhe ato përballohen nga punëdhënësi, përkatësisht ndahen nga paga bruto e punëtorit.

Punëdhënësi që nuk do ta mbajë personin edhe për 12 muaj pas skadimit të periudhës në të cilën është i liruar nga pagesa e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore është i detyruar që në afat prej 15 ditësh të paguaj kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror, në përputhje Ligjin e kontributeve.

Punëdhënësi është i detyruar që brenda 24 muajve nga data e punësimit të një personi nën 29 vjet të mos zvogëlojë numrin e të punësuarve, përveç në raste të vdekjes ose të daljes në pension. Punëdhënësi i cili pa arsye do të anulohet kontratën e punës, brenda 15 ditëve obligohet për të punësuar një person tjetër të papunë nën 29 vjeç për periudhën e mbetur deri në 24 muaj ku do të merret parasysh dhe periudha e mbetur deri në 12 muaj për lirim nga pagesa e kontributeve për sigurimin e detyrueshëm social.

Edhe pse baza ligjore është vënë në mars të vitit 2014 për herë të parë APRM sigurojë fonde për zbatimin e masës për punësim të subvencionuar të rinjve të papunë deri në 29 vjet nëpërmjet lirimet të kontributeve në kuadër të Planit operativ për shërbimet në tregun e punës dhe programet dhe masat aktive të punësimit për vitin 2015 (Министерство за труд и социјална политика, 2015).

Në pikën 3.3 të Planit theksohet se qëllimi i masës është që të inkurajojë bizneset për të punësuar të rinjtë e moshës deri në 29 vjet.

Qëllimi do të arrihet me lirim nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat personale të parashikuar për punëdhënësit që punësojnë persona të regjistruar si të papunë të moshës nën 29 vjet, në përputhje me dispozitat e Ligjit për punësim dhe sigurim nga papunësia.

Sipas Planit operativ të MPPS, shfrytëzuesit individual të masës do të jenë 5,000 të rinj të papunë nga evidenca e kërkuesve aktiv të punës në APRM.

Mjetet e nevojshme për zbatimin e masës përfshijnë : 292 800 000 denarë, ose rreth 4.76 milionë euro nga buxheti i shtetit të RM.

FAKTET PËR MASËN

Masa ka një periudhë të kufizuar 2 vjeçare : nga 13 marsi i vitit 2014 deri 13 mars 2016 Vazhdimi i paraparë i kësaj mase në Planin e Veprimit për Punësimin e të rinjve për periudhën 2016 - 2020 ende nuk ka mbështetje ligjore.

Shuma maksimale e kontributeve që mund të bien në buxhetin e shtetit, për shkak të operacionalizimit të kësaj mase sipas viteve është dhënë më poshtë:

Parametrat hyrëse:

- Paga bruto për punëtor në Republikën e Maqedonisë për vitin 2013 31 025 denarë
- Paga bruto për punëtor në Republikën e Maqedonisë për vitin 2014 31 325 denarë
- Duke pasur parasysh se paga bruto për të punësuar në RM për vitin 2015 do të publikohet më 25 shkurt, 2016, në llogaritje është marrë masa e shpallur e vitit të kaluar (31,325 dinarë).

Përshkrimi	2014	2015	2016
Bruto-paga	31.025	31.325	31.325
Kontribute total (27%)	8.377	8.458	8.458
SPI(18%)	5.585	5.639	5.639
Shëndetësi (7,3%)	2.265	2.287	2.287
Punësim (1,2%)	372	376	376
Shëndetësi prof. (0,5%)	155	157	157
Lirim personal	7.276	7.320	7.357
Tatimi personal (10%)	1.537	1.555	1.551
NETO-PAGA	21.111	21.312	21.316

Shuma maksimale mujore e kontributeve të pagave për periudhën e vlefshmërisë së masës është: për vitin 2014 = 8377 denarë; për 2015 = 8458 denarë dhe për 2016 = 8458 denarë.

Shuma e fondeve të planifikuara të nevojshme për zbatimin e masës ka dalë si më poshtë (është sqaruar në fusnotën nr. 5 në faqen 28 të Planit Operativ për shërbimet në tregun e punës dhe programet dhe masat aktive për punësim në vitin 2015): „në vitin 2014, 37 për qind e pagës mesatare mujore bruto arriti në 4.880 denarë. „

Nëse aplikohen hyrëset e supozuara do të fitohet vëllimi i planifikuar mjeteve: 4.880 në muaj x 12 muaj x 5000 persona = 292.800.000 denarë⁴.

Një mënyrë jo konsistente, planifikuesit në përqindje prej 37 për qind e kanë përfshirë e dhe tatimi mbi të ardhurat personale dhe ka marrë shumën e subvencionit prej 4.880 denarë në muaj për punëtorë të subvencionuar për të gjitha taksat publike. të pagave

Në analizën e kostove dhe përfitimeve kemi shfrytëzuar sasinë e parashikuar të Planit Operativ për vitin 2015 (Министерство за труд и социјална политика, 2015), si dhe faktet për numrin e të punësuarve të rinj deri në 29 vjet, sipas kësaj mase.

⁴ Sipas planit të veprimit për punësimin e të rinjve në vitet 2016-2020, faqja 11 në fund të vitit 2014 me këtë masë u përfshinë 5.750 të rinj me mbështetje të përgjithshme prej 217 milion denarë.

Vini re: Kemi konstatuar se në ndryshimin e parë të Planit operativ për shërbimet në tregun e punës dhe programet dhe masat aktive për punësim në 2015 (Министерство за труд и социјална политика, 2015) në faqen e pesë, në pjesën V Korniza financiare, në vend të planifikimit të mjeteve fillestare në vlerë prej 292.800.000 denarë për realizimin e Programit për punësim të subvencionuar të rinjve të papunë deri në 29 vjet nëpërmjet lirimt nga kontributet e parashikuara NUK JANË PARAPARË MJETE për realizim. Shpjegimi nga ana e menaxhmentit të APRM është se këto fonde do të mbulohen nga linja buxhetore e Ministrisë së Financave.

Dhe në ndryshimin e dytë të Planit operativ për 2015 (Министерство за труд и социјална политика, 2015), kjo masë përsëri nuk ka siguruar kurrfarë fondesh.

Mungesa e të dhënave mbi shumën e fondeve të nevojshme për zbatimin e masës e imponoi nevojën për të vënë disa hyrëse të supozuara për analizën e kostove dhe përfitimeve.

Në Planin operativ të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në vitin 2016, kjo masë është shndërruar në masë „Maqedonia punëson“, me përfshirjen e personave prej 15 deri në 58 vjet ose deri në pensionim. Për grupin e synuar të përdoruesve deri në 29 vjet nuk qenë siguruar të dhënë nga burimet zyrtare.

Në Planin operativ për vitin 2016 konfirmohet që të realizohet shkalla e pjesëmarrjes të të rinjve deri 29 vjet të paktën 30 për qind.

Nëse e marrim parasysh këtë pjesëmarrje, atëherë në vitin 2016 për punësim të subvencionuar të të rinjve të papunë deri 29 vjet, nëpërmjet lirimt nga kontributet / tatimi mbi të ardhurat personale, do të përdoren mjete prej 152.262 000 dinarë (507.540.000 denarë x 30 %). Duke aplikuar parametrat hyrëse për sasinë e kontributeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale (në muaj për punëtor = 4.880 denarë për kontributet dhe TVSH), delë se janë planifikuar 2.600 vendeve të punës të të rinjve deri në 29 vjet në kuadër të projektit „Maqedonia punëson“.

Sipas planeve operative të MPPS në 2015 dhe 2016 parashikohet punësim për një total prej 7,600 të rinjsh deri në 29 vjet.

ANALIZA E KOSTOVE DHE PËRFITIMEVE

Sipas informatave të marra në përputhje me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, numri i personave të papunë deri në 29 vjet në 14.01.2015 arriti në 28.080, prej tyre 13,007 janë gra, dhe 15,073 veta janë meshkuj.

Për të gjithë periudhën e analizës së masës, duke filluar nga 03/13/2014 deri më 01/14/2016, numri i të rinjve të punësuar deri në 29 vjet llogaritet në 11 261 persona, nga të cilët 5.310 janë gra dhe 5.951 janë meshkuj.

PUNËSIMI I SUBVENCIONUAR

Lloji i arsimit	Numri i personave	Struktura
Fillor	1.488	13,21%
I mesëm	6.855	60,87%
I lartë	25	0,22%
Superior	2.675	23,76%
Magjistra dhe doktor shkencash	218	1,94
Gjithsej	11.261	100%

Sipas informatave jozyrtare nga APRM, vetëm 2,397 të rinj kanë humbur të drejtën e fituar për lirim nga kontributet për arsye të ndryshme.

Punësimi i të rinjve deri në 29 vjet është realizuar gjithsej në 5307 subjekte afariste, dhe atë 84 për qind në subjekte afariste me më pak se 10 të punësuar.

Shumica e personave janë punësuar në Shkup (24.25%), Shtip (9.27%), Koçan (7.28%), Strumicë (6.88%) dhe Tetovë (6,40%).

Për suksesin e kësaj mase është e rëndësishme të theksohet se ka dhënë efekte punësimi prej 40 për qind të të rinjve të papunë!?

SUPOZIME E HYRËSEVE

Numri i të rinjve të punësuar sipas viteve

Duke pasur parasysh faktin se numri i përgjithshëm i të punësuarve të rinj me këtë masë të analizuar deri në 31.12.2015 arriti 11,261, pra sipas planit operativ, në vitin 2015, janë punësuar 5.000 persona, del se e në vitin 2014 janë punësuar 6261 persona. Sipas Planit operativ për vitin 2016 parashihen punësime të 2600 të rinjve (duke përfunduar me 13 marsin e 2016). Efekti i përgjithshëm i masës në përfundimin e saj do të jetë 13,861 vende të reja të subvencionuara për të rinjtë deri në 29 vjet.

Viti 2014

Duke pasur parasysh se masa „punësimi i subvencionuar i të rinjve deri në 29 vjet nëpërmjet lirimit nga kontributet „ ka filluar të zbatohet nga 03.13.2014, dhe se shumica e punës është kryer në gjysmën e dytë të vitit 2014, janë llogaritur kontribute të subvencionuar në vlerë prej 4188 denarë + 405 denarë tatimi mbi të ardhurat personale, një total prej 4593 në muaj për person për gjashtë muaj, ose një shumë totale prej 172 540 638 dinarë (për 6.261 persona).

Punëdhënësit kanë paguar rroga (shuma mesatare mujore prej 10.880 denarë) mbi këtë bazë për gjashtë muaj të vitit 2014 në vlerë prej 408,718,080 denarë.

2015 година

Për vitin 2015 janë llogaritur kontributet dhe TPF për 6261 persona për gjashtë muajt e mbetur dhe 5000 punësime të tjera të planifikuara nga 4.880 denarë në muaj, për 12 muaj në vlerë prej 292.800.000 denarë, pra një shumë totale prej 465,340,638 denarë.

Për gjashtë muaj në vitin 2015, në kurriz të punëdhënësve ranë 172,540,638 denarë për kontribute.

Punëdhënësit kanë paguar pagat (shuma mesatare mujore prej 10,942 denarë) mbi këtë bazë për gjashtë muaj për 6261 personave të punësuar në vitin 2014 (411 047 172 denarë) dhe plus për 12 muaj për 5000 punonjës në vlerë prej 656.520.000, ose gjithsej: 1.067. 567 172 denarë.

Viti 2016

Për vitin 2016 janë llogaritur kontribute dhe TPF për 2.600 personi për 12 muaj nga 4798 në muaj për një total prej 149,697,600 denarë.

Për gjashtë muaj të vitit 2016, në shpinë të punëdhënësve do të bien 180,241,668 denarë për kontribute për të punësuarit në vitin 2014 dhe 287.880,00 denarë për të punësuarit në vitin 2015, pra një shumë totale prej 469,121,668 denarë.

Punëdhënësit kanë paguar pagat (shuma mesatare mujore prej 11,336 denarë) mbi këtë bazë për 12 muaj nga viti 2016, 7600 personave (1,033,843,200 denarë).

Viti 2017

Për vitin 2017 janë llogaritur kontributet dhe TFP për 2,600 veta për dy muaj nga 4798 në muaj, me një total prej 24,949,600 denarë.

Për gjashtë muaj të vitit 2016, do të bjerë një barrë për punëdhënësit prej 180,241,668 denarë për kontribute për të punësuarit në vitin 2014 dhe 287.880.000 denarë për të punësuarit në vitin 2015, pra një shumë totale prej 469,121,668 denarë.

Vini re: Mjetet e përdorura për pagesën e kontributeve sociale për masën e analizuar përfshijnë koston e oportune të inkriminuar duke marrë parasysh se nuk mund të përdoren për qëllime të tjera (të cilat do të sillnin fitim) nga njëra anë, por nga ana tjetër, derdhja e mjeteve në fondet sociale mbi këtë bazë redukton shpenzimet e Fondeve për huamarrjen e mundshme për të bërë pagesën e detyrimeve rrjedhës (pensionet dhe sigurimin shëndetësor) për shumën e mjeteve të paguara për kontributet që rezultojnë nga masa analizuar.

Viti 2018-2020

Punëdhënësit në periudhën 2017 - 2020 vjet, do të paguajnë rroga vjetore në shumë totale prej 1,033,843,200 denarë.

Tabela 3. Analiza e kostove dhe përfitimeve (tabela sipas viteve)

Përkrahimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	
Shpenzime								
Shpenzime organizative								
Shuma e kontributeve në kurriz të Buxhetit dhe shpenzuar për tatimin personal të fitimit	172.540.638	465.340.638	149.697.600	24.949.600	0	0	0	
Shpenzimet private								
Shpenzimet e kompanive për kontribute pas 12 muajsh dhe PPF pas 36	0	172.540.638	469.121.668	615.038.238	615.038.238	615.038.238	615.038.238	
Shpenzime për rroga në kurriz të punëdhënësit	408.718.080	1.067.567.172	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	
Shpenzime private totale	408.718.080	1.240.107.810	1.502.964.868	1.648.881.438	1.648.881.438	1.648.881.438	1.648.881.438	
Shpenzime totale:	581.258.718	1.705.448.448	1.652.662.468	1.673.831.038	1.648.881.438	1.648.881.438	1.648.881.438	
Përfitimet								
Përfitimet shoqërore								
Të ardhurat në fondet sociale dhe në Buxhet	0	172.540.638	469.121.668	615.038.238	615.038.238	615.038.238	615.038.238	
Shtimi i kërkesës dhe i GDP	40.871.808	106.756.717	103.384.320	103.384.320	103.384.320	103.384.320	103.384.320	
Përfitimet e përgjithshme shoqërore	40.871.808	279.297.355	572.505.988	718.422.558	718.422.558	718.422.558	718.422.558	
Përfitimet private të Kompanive								
Përfitimet për kompanitë, kursime të kontributeve dhe të tatimit personal të fitimit	172.540.638	465.340.638	149.697.600	24.949.600				
Përfitimet private për të punësuarit								
Të ardhurat nga rroga për të punësuarit	408.718.080	1.067.567.172	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	1.033.843.200	
Përfitimet e përgjithshme	622.130.526	1.812.205.165	1.756.046.788	1.777.215.358	1.752.265.758	1.752.265.758	1.752.265.758	
Neto përfitimet Neto shpenzimet SHOQËRORE	- 161.668.830	- 186.043.283	422.808.388	693.472.958	718.422.558	718.422.558	718.422.558	
Përfitimet neto-Shpenzimet neto të përgjithshme	40.871.808	106.756.717	103.384.320	103.384.320	103.384.320	103.384.320	103.384.320	
Vlera aktuale neto e përgjithshme (Diskontimi)	40.871.808	98.002.666	87.152.982	80.019.464	73.506.252	67.406.577	61.927.208	
Shkalla e diskontit (8,90%)		0,918	0,843	0,774	0,711	0,652	0,599	
Vlera e përgjithshme neto aktuale (7 vjet)			468.015.148 denarë					7,6 milion euro

ANALIZA CILËSORE

Punësimi sjell një gamë të gjerë të përfitimeve dhe efekte shoqëruese për ekonominë dhe për shoqërinë në tërësi.

Ndikimet më të gjera sociale të masës për punësimin e të rinjve deri në 29 vjet nga subvencionimi i kontributeve e pagave i kemi në fushat e sa vijon:

- Zvogëlimi papunësisë së madhe tek të rinjtë nën 29 vjet,
- Mbajtja e të rinjve në vend,
- Rritja e mirëqenies individuale për shkak të të ardhurave më të larta
- Rritja e të ardhurave të e bizneseve të ndërlidhura (transporti, ushqimi, kujdesi për fëmijët, turizmi, ...)
- Nxitja e aktivitetit ekonomik,
- Zvogëlimi i vëllimit të ekonomisë joformale,
- Përmirësimi i gjendjes sociale të të rinjve,
- Zvogëlimi i vëllimit dhe demotivimit të emigrimit ekonomik të të rinjve,
- Rritja e vetëbesimit dhe shëndetit të të punësuarve,
- Kursimi i shpenzimeve individuale për shkak të zvogëlimit të kohës së lirë,
- Përmirësimi i kujdesit shëndetësor në përgjithësi,
- Ulja e shkallës së krimit,
- Rritja e të ardhurave publike (TPF dhe kontributet e ardhshme pas përfundimit të masës)
- Ndikimi sekondar në zhvillimin ekonomik (konsumi)
- Rritja e fuqisë blerëse.


Disa shpenzime të pashmangshme për kalimin nga gjendja e papunësisë në punësim:

- Shpenzimet e udhëtimit për / nga puna
- Shpenzimet për kujdesin e fëmijëve (prindër të vetëm)

Këto shpenzime duhet të hiqen nga paga neto të sapo punësuarve. Këta persona shpenzim paraqet edhe koha e lirë e humbur të cilën mund ta shfrytëzonin për ndonjë lloj të punës joformale. Për fat të keq, të ardhurat e humbura të këtilla, kryesisht janë kompensuar në mënyra tradicionale.

Masa e subvencionuar të punësimi të të personave deri në 29 vjet ka rezultat negativ, tek kategoritë e tjera të personave të papunë duke i zhvendosur ato nga mundësitë e konkurrencës për të gjetur punë në kushte të njëjta. Kjo pjesërisht është neutralizuar me përfshirjen punësimi të subvencionuar edhe të grupeve të moshave të tjera.

Grafiku 3. Aspekti social i analizës së kostove dhe përfitimeve



Burimi: Fujiwara, 2010

PËRFUNDIM

Shpenzimet totale të Buxhetit për zbatimin e masës për punësimin të subvencionuar të të rinjve deri në 29 vjet në periudhën 2014-2017 përfshijnë 812,528,476 denarë (13.2 milionë euro). Mjetet nuk kanë humbur përgjithmonë, por transferohen në fondet e sigurisë sociale dhe paraqesin kursime të drejtpërdrejta për kompanitë që punësojnë të rinjtë deri në 29 vjet. Në të njëjtën periudhë kompanitë kanë shpenzime për pagat neto, të cilat nga njëra ana paraqesin të ardhura për çdo punëtor veç e veç.

Pagat neto të punonjësve sipas regjimit të multiplikimit social dhe ekonomik ndikojnë në shumë grupe sociale dhe ekonomike dhe nxisin konsumin që akceliron në zhvillimin social-ekonomik, sipas nesh rreth 10 për qind, duke u bazuar materialin e theksuar të „Fudzhivara” (Fujiwara) (2010). Pikërisht ky ndikim i tërthortë i masës reflektojnë në vlerën e saj ekonomike në një shumë prej rreth 6.7 milion.

Për fat të keq, mungesa e informacionit në bëri planifikues të vëmendshëm të efekteve të parapara të masës, në radhë të parë në drejtim të braktisjes së një pjese të punëtorëve pas plotësimit të të gjitha kushteve.

REKOMANDIME

Për shkak të anëve pozitive të pakontestueshme, masa duhet të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme (afat mesëm). Paralelisht me zgjerimin, masa duhet të përmirësohet në fushat sa vijon:

- Subvencionimi i kontributeve të mos llogaritet bazën minimale për krijimin e përfitimeve sociale, por sipas pagës mesatare republikane (rrogë dy herë më e lartë dhe baza e kontributeve);
- Të sigurojë një mekanizëm për pagesën e pagave më të larta për të rinjtë dhe kontroll gjatë zbatimit në terren;
- Po anketohen të rinjtë e punësuar dhe të kërkohen rekomandime kthyesë për mënjanimin e defekteve dhe përparimin e ndikimeve pozitive të masës;
- Në të njëjtën mënyrë të anketohen edhe subjektet afariste që e shfrytëzojnë masën për punësimin e të rinjve;
- Të anketohen subjektet afariste për arsyet pse nuk kanë kërkuar të shfrytëzojnë masën, ose kanë kërkuar por janë refuzuar.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Министерство за труд и социјална политика на РМ (2011) *Национална стратегија за вработување во Република Македонија, 2015 година.*
- [2] Министерство за труд и социјална политика на РМ (2015) *Оперативен план за услуги на пазарот на труд и активни програми и мерки за вработување за 2015 година.*
- [3] Министерство за труд и социјална политика на РМ (2015) *Оперативен план за дојолнување и изменување на Оперативниот план за услуги на пазарот на труд и активни програми и мерки за вработување за 2015 година.* Април, 2015. Скопје.
- [4] Министерство за труд и социјална политика на РМ (2015) *Оперативен план за дојолнување и изменување на Оперативниот план за услуги на пазарот на труд и активни програми и мерки за вработување за 2015 година.* Ноември, 2015. Скопје.
- [5] Министерство за труд и социјална политика на РМ (2016) *Оперативен план за активни програми и мерки за вработување и услуги на пазарот на трудот за 2016 година.*
- [6] Службен весник на РМ бр. 44/2014. *Закон за вработување и осигурување во случај на невработеност.*
- [7] Службен весник на РМ бр. 142/2008 и 129/2015. *Закон за придонеси од задолжително социјално осигурување.*
- [8] Службен весник на РМ бр. 11/2012 и 180/2014. *Закон за минимална плата во Република Македонија.*
- [9] Fujiwara, D. (2010) Methodologies for estimating and incorporating the wider social and economic impacts of work in Cost-Benefit analysis of employment work. *Department for work and pensions. Working paper No. 86.*